



Art in
Embassies
Exhibition

United
States
Embassy
Tirana

MARLOWE EMERSON

After the Rainbow, 2020. Mixed media, 48 x 48 in. Courtesy of the artist, Richmond, Virginia
Pas Ylberit, 2020. Media e përzier, 121,9 x 121,9 cm. Kortezi e artistes, Riçmond, Virxhinia

ART IN EMBASSIES

Established in 1963, the U.S. Department of State's office of Art in Embassies (AIE) plays a vital role in our nation's public diplomacy through a culturally expansive mission, creating temporary and permanent exhibitions, artist programming, and publications. The Museum of Modern Art first envisioned this global visual arts program a decade earlier. In the early 1960s, President John F. Kennedy formalized it, naming the program's first director. Now with over 200 venues, AIE curates temporary and permanent exhibitions for the representational spaces of all U.S. chanceries, consulates, and embassy residences worldwide, selecting and commissioning contemporary art from the U.S. and the host countries. These exhibitions provide international audiences with a sense of the quality, scope, and diversity of both countries' art and culture, establishing AIE's presence in more countries than any other U.S. foundation or arts organization.

AIE's exhibitions allow citizens, many of whom might never travel to the United States, to personally experience the depth and breadth of our artistic heritage and values, making what has been called a "footprint that can be left where people have no opportunity to see American art."

<https://art.state.gov/>

ART NË AMBASADA

Themeluar në vitin 1963, zyra e Art në Ambasada (AnA) e Departamentit të Shtetit të SHBA luan një rol jetësor në diplomacinë publike të vendit tonë nëpërmjet një misioni të gjerë nga pikëpamja kulturore, duke krijuar ekspozita të përkohshme dhe të përhershme, programe me artistë, si dhe botime. Muzeu i Artit Modern e kishte parashikuar këtë program global të artit pamor një dekadë më herët. Në fillim të viteve 1960-të, Presidenti John F. Kennedy e formalizoi atë, duke emëruar edhe drejtorin e parë të programit. Me më shumë se 200 mjedise tashmë, AnA kuron ekspozita të përkohshme dhe të përhershme për mjediset përfaqësuese të të gjitha godinave të ambasadave, konsullatave dhe rezidencave të SHBA kudo në botë, duke përzgjedhur dhe autorizuar përdorimin e artit bashkëkohor nga SHBA dhe vendet pritëse. Këto ekspozita iu ofrojnë audiencave ndërkombëtare një ndjenjë të cilësisë, shtrirjes dhe shumëllojshmërisë të artit dhe kulturës të të dy vendeve, duke vendosur kështu praninë e AnA në më shumë vende të botës se sa çdo fondacion apo organizatë arti tjetër nga SHBA.

Ekspozitat e AnA lejojnë qytetarët e huaj, shumë nga të cilët mund të mos udhëtojnë ndonjëherë në Shtetet e Bashkuara, që të përjetojnë personalisht thellësinë dhe gjerësinë e trashëgimisë dhe vlerave tona artistike, duke krijuar atë që është quajtur një: "gjurmë që mund të lihet kur njerëzit nuk kanë mundësi të shohin artin amerikan."

<https://art.state.gov/>

INTRODUCTION

What is to become of us? Are we mere subjects of an immutable destiny, or are we the masters of our fate? Does history weigh us down? What does it take to break free, to spread our wings and take flight? The art I have chosen for the Residence of the U.S. Ambassador to Albania answers: We can choose. And so, we must choose hope over despair, courage over fear, future over past. Individually and together, the art you see here expresses the optimism, energy, and persistence that have fueled every forward movement in human history. They also tell the story of America and Albania. These artworks speak to our peoples' impetus to choose a better future.

From Susan Eder's *Resting (Monarch)*, which could take flight at any moment, to Marlowe Emerson's *After the Rainbow*, the works emphasize the idea of potential. Maggie O'Neill's *Circle* invites us to think about perspective, reminding us that things are often different than they first appear. Pieces by Namwon Choi and Shirley Jo Rimkus-Falconer allow us to explore the idea of navigating between cultures while recognizing our unity even through our differences. Together, these works, along with the works of Lori Katz and Eric Standley, create a compelling exhibition showcasing the diversity and power of American art.

HYRJE

Çfarë do të ndodhë me ne? A jemi subjekte të një fati të caktuar apo jemi zotër të fatit tonë? A peshon historia tek ne? Çfarë do të thotë të çlirohesh, të hapësh krahët dhe të fluturosh? Arti që kam zgjedhur për Rezidencën e Ambasadores së SHBA në Shqipëri e jep përgjigjen: Mund të zgjedhim. Dhe kështu, duhet të zgjedhim shpresën kundrejt dëshpërimit, kurajën kundrejt frikës, të ardhmen kundrejt të kaluarës. Individualisht dhe së bashku, arti që shihni këtu shpreh optimizmin, energjinë dhe këmbënguljen që ka ushqyer çdo lëvizje përpara në historinë njerëzore. Këto punime flasin për shtysën e popujve tanë për të zgjedhur një të ardhme më të mirë.

Nga Pushimi i Susan Eder (*Flutura Monarch*), e cila mund të niset në fluturim në çdo çast, tek Pas Ylberit e Marlowe Emerson, punimet theksojnë idenë e potencialit. Punimi Rrethi nga Maggie O'Neill na fton të mendojmë për perspektivën, duke na kujtuar se gjërat shpesh janë ndryshe nga sa duken në fillim. Punimet nga Namwon Choi dhe Shirley Jo Rimkus-Falconer na lejojnë të eksplorojmë idenë e lundrimit mes kulturave ndërkohë që njohim bashkimin tonë edhe nëpërmjet dallimeve tona. Së bashku, këto punime, bashkë me ato nga Lori Katz dhe Eric Standley, krijojnë një ekspozitë bindëse që paraqet shumëllojshmërinë dhe fuqinë e artit amerikan.

I am grateful to the talented artists who created these pieces and have generously allowed me to share them with you. I also thank the Art in Embassies program staff for their hard work and dedication to creating this exhibition and catalog. I hope that these works prompt you to reflect on the limitless potential in our world, as they have done for me.

Ambassador Yuri Kim

*Tirana, Albania
February 2021*

I jam mirënjohëse artistëve të talentuar që i krijuan këto punime dhe më kanë lejuar bujarisht t'i ndaj ato me ju. Po ashtu, falenderoj personelin e programit Art në Ambasada për punën e tyre të palodhur dhe përkushtimin për ta krijuar këtë ekspozitë dhe këtë katalog. Shpresoj se këto punime do t'ju ngacmojnë të reflektoni mbi potencialin e pamatë në botën tonë, ashtu si më kanë ngacmuar mua.

Ambasadore Yuri Kim

*Tiranë, Shqipëri
Shkurt 2021*

NAMWON CHOI


“How we experience a place can have consequence to our lives. We continue to move from place to place in the search of greater opportunity and a better life. We are migrants, the fundamental parts of our societies, and I am an immigrant. I chose migrancy because it privileges movement in both space and time and the notion of movement and process rather than stability and fixity... The special and temporal condition of in-betweenness is not for pausing. It is for (dis)connecting here and there.”

Namwon Choi is an artist based in Savannah, Georgia. Choi acquired her Bachelor and Master of Fine Arts degrees in traditional Korean painting from Hongik University in Seoul, Korea, and her Master of Fine Arts degree in drawing and painting at Georgia State University in Atlanta. Her work has been exhibited at the New York City Korean Culture Center, the Los Angeles Korean Culture Center, and the Museum of Contemporary Art, Atlanta. She is currently a professor of foundation studies at Savannah College of Art and Design, Georgia.

NAMWON CHOI

“Mënyra si e përjetojmë një vend mund të ketë pasoja në jetët tona. Ne vazhdojmë të lëvizim nga një vend në tjetrin, në kërkim të mundësive më të mëdha dhe një jete më të mirë. Jemi migrantë, pjesë themelore e shoqërive tona, dhe unë jam një emigrante. Unë zgjodha migrimin sepse ajo favorizon lëvizjen në hapësirë dhe kohë dhe nocionin e lëvizjes dhe procesit në vend të stabilitetit dhe të fiksuarit... Gjendja e posaçme dhe kohore e të qëndruarit midis nuk është për pauza. Është për (mos)lidhjen këtu dhe atje.”


Namwon Choi është artiste e vendosur në Savana, Xhorxhia. Ajo mori diplomat Bachelor dhe Master të Arteve të Bukura në pikturën tradicionale koreane nga Universiteti Hongik në Seul, Kore, dhe diplomën Master të Arteve të Bukura në Universitetin Shtetëror të Xhorxhias, në Atlanta. Puna e saj është ekspozuar në Qendrën e Kulturës Koreane të Nju Jorkut, Qendrën e Kulturës Koreane të Los Anxhelesit, si dhe në Muzeun e Artit Bashkëkohor, Atlanta. Aktualisht, është profesoreshë për studimet themelore në Kolegjin e Artit dhe Dizajnit të Savanas, në Xhorxhia.



In-betweenness (configuration-1), 2019. Gouache on panel, 30 x 30 in. Courtesy of the artist, Savannah, Georgia
Midisja (konfigurim-1), 2019. Bojë opake në panel, 76,2 x 76,2 cm. Kortezi e artistes, Savana, Xhorxhia



Blue Distant (Portals and Points), 2019. Gouache on panel, 12 x 12 in. Courtesy of the artist, Savannah, Georgia
E largëta Blu (Portale dhe Pika), 2019. Bojë opake në panel, 30,5 x 30,5 cm. Kortezi e artistes, Savana, Xhorxhia



Blue Distant (Portals and Points), 2019. Gouache on panel, 12 x 12 in. Courtesy of the artist, Savannah, Georgia
E largëta Blu (Portale dhe Pika), 2019. Bojë opake në panel, 30,5 x 30,5 cm. Kortezi e artistes, Savana, Xhorxhia

SUSAN EDER

(born 1950)

“Since 1975, I have been using my camera as a tool for gathering specimens from the world at large. Nothing, I swiftly discovered, comes pure to the eye. The mere act of perceiving quickly covers even the most commonplace things in a swaddling of contexts, associations, and metaphors. And when photographed, even the heaviest, most mundane objects lose their materiality in favor of the particular meanings we wrap around them. I try to stay alert, especially to what is wrapped around the most familiar things.”

Northern Virginia-based photographer Susan Eder’s content-oriented approach to photography was influenced early on by conceptual art and structuralist filmmaking. Using gentle interventions and curious juxtapositions, she uncovers the metaphoric power lurking in everyday objects in her artistic practice. Born in St. Louis, Missouri, Eder received her Bachelor of Fine Arts degree from the University of Michigan, Ann Arbor, and her Master of Fine Arts degree from Ohio State University, Columbus. Her photography is included in museum, corporate, and private collections and has been shown in national and international venues. She has received fellowships from the National Endowment for the Arts, the Fairfax County Arts Council, and the Virginia Museum of Fine Arts, Richmond.

SUSAN EDER

(lindur në 1950)

“Nga viti 1975, e kam përdorur aparatën fotografikë si mjet për të mbledhur mostra nga bota në përgjithësi. Shumë shpejt zbulova se asgjë nuk vjen e pastër tek syri. Thjesht akti i të perceptuarit shpejt mbulon edhe gjërat më të zakonshme në një mbivendosje kontekstesh, shoqërimesh, e metaforash. Dhe kur fotografohen, edhe objektet më të rënda, më ordinere e humbin materialitetin e tyre kundrejt kuptimeve të veçanta që iu përveshim atyre. Përpiqem të rri syhapur, sidomos ndaj atyre që veshin gjërat më të njohura.”

Përqasja ndaj fotografisë duke u bazuar tek përmbajtja e fotografes së vendosur në Virxhinian Veriore Susan Eder u ndikua që herët nga arti konceptual dhe regjizura strukturaliste. Duke përdorur ndërhyrje të lehta si dhe vendosje kureshtare, ajo zbulon fuqinë metaforike që gjendet pranë sendeve të përditshme në praktikën e saj artistike. E lindur në St. Louis, Mizuri, Eder mori diplomën Bachelor për Artet e Bukura ng Universiteti i Michigan, Ann Arbor, dhe diplomën Master e Arteve të Bukura nga Universiteti Shtetëror i Ohajos, Columbus. Fotografitë e saj gjenden në koleksione muzesh, korporatash si dhe koleksione private dhe janë ekspozuar në mjedise kombëtare dhe ndërkombëtare. Eder ka marrë bursa nga National Endowment for the Arts, Këshilli i Artit i Kontesë Fairfax, si dhe Muzeu i Arteve të Bukura të Virxhinias në Riçmond.



Resting (Monarch), 1996. Matted Ilfochrome print, 28 x 20 in. Collection of Art in Embassies, Washington, D.C.
Pushimi (Flutura Monarch), 1996. Printim mat ilfokrom, 71,1 x 50,8 cm. Koleksioni i Art në Ambasada, Uashington, D.C.

MARLOWE EMERSON

“My work is about exploring the limits of spontaneity in painting and drawing, playing with a tension between simplicity and complexity. I love the emotion of color and the immediacy of scribbling, mark making, and other expressionist techniques. The resulting layers of paint and paper become a testament to the ways in which art records individual experience. The process is intuitive and personal. It contrasts the attitude of organic forms frozen in time to the vibrant energy of the brushstroke.”

Marlowe Emerson, a mixed-media artist from Virginia Beach, Virginia, creates large-scale abstract paintings using acrylic and collage techniques. The primary focus of her work is the intuitive process of painting and the value of abstract expressionism as a meditative practice, and she credits living between the forest and the sea as her biggest inspiration. She received a Bachelor of Science degree in French and art history from Georgetown University, Washington, D.C., after which she spent seven years studying painting in the south of France. Her work has been shown in museums and galleries internationally. She currently teaches abstract painting at the Virginia Museum of Contemporary Art, Richmond.

MARLOWE EMERSON

“Puna ime ka të bëjë me eksplorimin e kufijve të spontanitetit në pikturë dhe vizatim, me lojën me një tension midis thjeshtësisë dhe kompleksitetit. E dua shumë emocionin e ngjyrës dhe afërsinë e zhgaravitjeve, lënies së shenjave, dhe teknikave të tjera ekspresioniste. Shtresat e bojës dhe letrës që përtohen bëhen testament i mënyrave se si arti regjistron përvojën individuale. Procesi është intuitiv dhe personal dhe bën kontrastin midis qëndrimit të formave organike të ngrira në kohë me energjinë e gjallë të lëvizjes së penelit.”

Marlowe Emerson, artiste e medimeve të përziera nga Virxhinia Biç në Virxhinia, krijon piktura të mëdha abstrakte duke përdorur teknika akriliku dhe kolazh. Fokusi parësor i punës së saj është procesi intuitiv i të pikturuarit dhe vlera e ekspresionizmit abstrakt si praktikë medituese. Sipas saj, frymëzimin më të madh e merr nga të jetuarit midis pyllit dhe detit. Mori diplomën Bachelor e Shkencës në Frengjisht dhe histori arti nga Universiteti Xhorxhtaun, Uashington, D.C., dhe më pas kaloi shtatë vite duke studiuar pikturën në jug të Francës. Puna e saj është ekspozuar në muze dhe galeri ndërkombëtarisht. Aktualisht, jep lëndën e pikturës abstrakte në Muzeun e Artit Bashkëkohor të Virxhinias, në Riçmond.



After the Rainbow, 2020. Mixed media, 48 x 48 in. Courtesy of the artist, Richmond, Virginia
Pas Ylberit, 2020. Media e përzier, 121,9 x 121,9 cm. Kortezi e artistes, Riçmond, Virxhinia

LORI KATZ

(born 1957)

“I am intrigued by contrast, the play of dark against light, the pull of empty space against the inclination to fill it up, the placement of line and shape, the use of subtle texture, balance. Several years ago, I began working almost exclusively in a palette of black and white in what was a conscious effort to simplify process and design. Lately, color is finding its way back in as my work continues to evolve. I have learned that in the end, process is never simple and good design is always balanced and strong.”


Lori Katz has worked as a ceramic artist in the Washington, D.C., area since 1979. Although known for exploring surface and texture, her current focus is on work for the wall. Her pieces are stoneware with some mixed media. Additions to the raw surface can include contrasting clays, slips, underglaze, and high-temperature wire. Post-firing additions can include acrylic paint, oil paint, cold wax, and metal leaf. Katz maintains a studio at the Torpedo Factory Art Center in Alexandria, Virginia, and is an instructor in the ceramics departments at the Art League School and the Lorton Arts Foundation, also in Virginia. Her work has been selected for exhibitions in the United States, Europe, and Asia and is included in public and private collections worldwide.

LORI KATZ

(lindur në 1957)

“Më intrigon kontrasti, loja e errësirës kundër dritës, tër-heqja e hapësirës bosh kundër prirjes për ta mbushur atë, vendosja e linjave dhe formave, përdorimi i teksturës delikate, balancës. Disa vjet më parë, fillova të punoja thujse ekskluzivisht në një paletë bardhë e zi, në një përpjekje të ndërgjegjshme për të thjeshtësuar procesin dhe dizajnin. Kohët e fundit, ngjyra po e rigjen veten prapë tek unë, teksa puna ime vazhdon të zhvillohet. Kam mësuar se në fund, procesi asnjëherë nuk është i thjeshtë dhe dizajni i mirë është gjithmonë i balancuar dhe i fortë.”

Lori Katz ka punuar si artiste qeramike në zonën e Washington, D.C., nga viti 1979. Edhe pse njihet për eksplorimin e sipërfaqes dhe teksturës, fokusi i saj i tanishëm është tek puna për muret. Punimet e saj janë punime guri me disa medime mikse. Shtesat në sipërfaqe mund të përfshijnë baltat kontrastuese, përzierjet me ujë, nën-glazurën, dhe telat me temperaturë të lartë. Shtesat më pas mund të përfshijnë bojë akrilik, bojë vaji, dyll të ftohtë dhe gjethe metali. Katz ka një studio në Qendrën e Artit të Fabrikës Torpedo në Aleksandri të Virxhinias dhe është pedagoge në departamentet e qeramikës në Shkollën e Ligës së Artit dhe Fondacionin Lorton për Artet, po ashtu në Virxhinia. Punimet e saj janë zgjedhur për ekspozita në Shtetet e Bashkuara, Europë, dhe Azi dhe përfshihet në koleksione publike e private në mbarë botën.



Untitled, set of 9. Ceramic and mixed media, 5 x 5 x 2 ½ in. each. Courtesy of the artist, Alexandria, Virginia
Pa titull, set prej 9 pjesësh. Qeramikë dhe mikse, 12,7 x 12,7 x 6,4 cm secila. Kortezi e artistes, Aleksandri, Virxhinia

MAGGIE O'NEILL

“I am inspired by COLOR and music, materials and mixed media, pop culture, social and political issues, and the human spirit that inspires risk-takers and innovators. Why color? Color affects every one of us in multiple, conscious and subconscious ways. We experience and react to color, much like music. I strive to create a visual language of experience, memory, and emotion. I continuously react to what is on the canvas—whether that canvas is wood, paper, cloth—pushing or instigating the next action in the painting process.”

Maggie O'Neill, an artist, designer, and creative entrepreneur, is best known for her iconic pop impressionistic paintings of Washington, D.C., landmarks, and both the famous and familiar individuals who inspire and make history. In 2018, O'Neill was selected to be the Official Artist of the National Cherry Blossom Festival. Her work has been featured in the *Washington Post* and collaborative murals in the D.C. area. O'Neill uses her art to impact communities—giving back and paying it forward to benefit charitable organizations such as Autism Speaks, Habitat for Humanity, D.C. Central Kitchen, Safe Shores, and Project Soar. She is the founder of SUPERFIERCE, an art exhibit that highlights female artists, assists benevolent organizations, and mentors aspiring artists.

MAGGIE O'NEILL

“Më frymëzon NGJYRA dhe muzika, materialet dhe mediumet mikes, kultura pop, çështjet sociale dhe politike, si dhe shpirti njerëzor që frymëzon ata që marrin përsipër rreziqe dhe novatorët. Pse ngjyra? Ngjyra ndikon secilin prej nesh në mënyra të shumëfishta, të ndërgjegjshme dhe të pandërgjegjshme. Ne e përjetojmë ngjyrën dhe reagojmë ndaj saj, si muzika. Përpiqem të krijoj një gjuhë pamore të përvojës, kujtesës dhe emocionit. Vazhdimisht reagoj ndaj asaj që është në pëlthurë – pavarësisht nëse pëlthura është dru, letër, cohë – duke nxitur ose shkaktuar veprimin tjetër në procesin e pikturës.”

Maggie O'Neill, artiste, dizenjatore, dhe sipërmarrëse krijuese, njihet më shumë për pikturat e saj impresioniste të ikonave pop të Uashington, D.C., vendeve të njohura, si dhe individëve të famshëm dhe të njohur që frymëzojnë dhe bëjnë histori. Në vitin 2018, O'Neill u zgjodh Artistja Zyrtare e Festivalit Kombëtar të Lulëzimit të Qershive. Puna e saj është prezantuar në *Washington Post* si dhe në muralet zonën e D.C. O'Neill e përdor artin për të ndikuar komunitetet – duke iu dhënë mbrapsht dhe duke përcjellë mirësinë për të mirën e organizatave bamirëse si Autism Speaks, Habitat for Humanity, D.C. Central Kitchen, Safe Shores, dhe Project Soar. Ajo është themeluese e SUPERFIERCE, një ekspozitë arti që vë në pah artiste femra, ndihmon organizata dashamirëse, si dhe udhëheq artistë të ardhshëm.



Circle, 2018. Mixed media, 32 ½ x 32 ½ in. Courtesy of the artist, Washington, D.C.
Rreth, 2018. Mikse, 82,6 x 82,6 cm. Kortezi e artistes, Uashington, D.C.

SHIRLEY JO RIMKUS-FALCONER

(1933–2011)

“Each person must see over the horizon, to rise to the top, and fly with their feathered friends. Our feathered friends warn us, bad things happen to them. But it’s worth it to be free.”

Textile artist Shirley Jo Rimkus-Falconer learned to sew for practical reasons—first clothing, then quilting. She studied fabric arts with others in her community, and her quilts became more straightforward examples of self-expression, giving her a voice and tackling issues at the forefront of her mind. Born in Portland, Rimkus-Falconer spent much of her life in Oregon, where she earned her Bachelor of Science degree from the University of Portland. She was fond of the outdoors, whether tending her garden, walking the beach, or hiking the trails of Mt. Hood.

SHIRLEY JO RIMKUS-FALCONER

(1933–2011)

“Çdo njeri duhet të shohë mbi horizont, të ngrihet në majë, dhe të fluturojë me miqtë fluturues. Miqtë tanë fluturues nga paralajmërojnë se iu ndodhin gjëra të këqia. Por prapë ia vlen të jesh i lirë.”

Artistja e tekstitit Shirley Jo Rimkus-Falconer mësoi të qepte për arsye praktike – në fillim veshje dhe pastaj shtroje. Studioi artet e pëlhurës me të tjerë në komunitetin e saj dhe shtrojet e saj u bënë shembuj më të drejt-përdrejtë të vetëshprehjes, duke i dhënë një zë dhe duke trajtuar çështjet që i rrinin në mend. E lindur në Oregon, Rimkus-Falconer e kaloi aty një pjesë të madhe të jetës, ku mori diplomën Bachelor e Shkencës nga Universiteti i Portlandit. I pëlqente puna jashtë, si kur kujdesej për kopshtin, kur ecte në breg të detit, apo ecte nëpër shtigjet e Malit Hood.



Peace Over Hate, 2000. Art quilt, 58 ½ x 57 ½ x 2 ¼ in. Collection of Art in Embassies, Washington, D.C.
Paqe në vend të Urrejtyes, 2000. Shtroje artistike, 148,6 x 146,1 x 5,7 cm. Koleksioni Art në Ambasada, Uashington, D.C.

ERIC STANDLEY

(born 1968)

“Technology circumscribes boundaries, as do artists. We are extended in body and mind by the advancements of what we envision and create.”

Adinine 1.1.1 is part of a series that arose in a collaboration between art professor Eric Standley and a team that included an entomology professor and a computer science professor working in biophysics, all studying the three-dimensional organization of chromatin, a key piece of the DNA puzzle. Their work inspired a series of layered paper-cut artifacts that visually represent the fundamental building blocks of life. More simply, this work is translating the language of three-dimensional chromosome organization into the language of art.

Standley is an associate professor of studio art at Virginia Tech, Blacksburg. He received his Bachelor of Fine Arts degree from the Massachusetts College of Art, Boston, and his Master of Fine Arts degree from Savannah College of Art and Design, Georgia. He has exhibited in over ninety museums and galleries around the world. Standley lives and works in Blacksburg, Virginia.


ERIC STANDLEY

(lindur 1968)

“Teknologjia përshkruan kufijtë, siç bëjnë edhe artistët. Ne zgjatemi në trup dhe mendje nga përparimet e atyre që imagjinojmë dhe krijojmë.”

Adinine 1.1.1 është pjesë e një serie që lindi në një bashkëpunim midis profesorit të artit Eric Standley dhe një ekipi që përfshinte një profesor të entomologjisë dhe një profesor të shkencave kompjuterike që punonte për biofizikën, të tre duke studiuar organizimin tri-dimensional të kromatinës, një pjesë kyç e gjëgjëzës së ADN-së. Puna e tyre frymëzoi një seri artefaktesh me shtresa, nga fletë të prera, që vizualisht përfaqësojnë blloqet ndërtuese të jetës. Më thjesht, ky punim përkthen gjuhën e organizimit tri-dimensional të kromozomeve në gjuhën e artit.

Standley është profesor i asociuar i artit të studios në Virginia Tech, Blacksburg. E mori diplomën Bachelor i Artit nga Kolegji i Artit të Masaçusets, në Boston, dhe diplomën Master të Arteve të Bukura nga Kolegji Savana i Artit dhe Dizajnit në Xhorxhia. Ka paraqitur ekspozita në mbi nëntëdhjetë muze dhe galeri në mbarë botën. Standley jeton dhe punon në Blacksburg, Virginia.



Adinine 1.1.1, 2019. Cut paper, wood, watercolor, gold leaf, 35 x 25 x 2 ½ in. Courtesy of the artist, Blacksburg, Virginia
Adinine 1.1.1, 2019. Letër, dru, bojë uji, fletë ari, 88,9 x 63,5 x 6,4 cm. Kortezi e artistit, Blacksburg, Virxhinia

ACKNOWLEDGMENTS

Washington, D.C.

Tori See, Curator and Editor
Jamie Arbolino, Registrar
Tabitha Brackens, Managing Editor
Megan Pannone, Editor
Amanda Brooks, Imaging Manager and Photographer

Tirana

Lucija Straley, Deputy Public Affairs Officer
Guri Lekloti, Translation
Antonio Cakshiri, Photography
Bora Dervishi, Photography

Vienna

Nathalie Mayer, Graphic Designer

Manila

Global Publishing Solutions, Printing

FALENDERIME

Uashington, D.C.

Tori See, Kuratore dhe Redaktore
Jamie Arbolino, Regjistrimi
Tabitha Brackens, Redaktore Menaxhuese
Megan Pannone, Redaktore
Amanda Brooks, Menaxhere Imazherie dhe Fotografe

Tirana

Lucija Straley, Zv. Zyrtare e Marrëdhënieve me Publikun
Guri Lekloti, Përkthimi
Antonio Cakshiri, Fotografi
Bora Dervishi, Fotografi

Vienë

Nathalie Mayer, Dizajn Grafik

Manila

Global Publishing Solutions, Shtypshkrimi



Published by Art in Embassies
U.S. Department of State, Washington, D.C.
February 2021
<https://art.state.gov/>